



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 01.03.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.02.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **”Gani B. Krasniqi B.I” nga Fushë Kosova**, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Institucioneve të Komunës së Lipjanit” me Nr. të Prok: 613-22-138-2-2-1.

V E N D I M

I Refuzohet: Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **”Gani B. Krasniqi B.I” nga Fushë Kosova** të dt. 28.02.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Institucioneve të Komunës së Lipjanit”, me nr. të Prok: 613-22-138-2-2-1.

Vërtetohet: Vendimi i AK për anulim të kësaj procedure. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për anulim të kësaj procedure i publikuar me datë: 22.02.2022.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anuloj aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **”Gani B. Krasniqi B.I” nga Fushë Kosova**, me datë 28.02.2022, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Institucioneve të Komunës së Lipjanit” me nr. të Prok: 613-22-138-2-2-1, ku këtë aktivitet AK ka anuluar dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik **”Gani B. Krasniqi B.I” nga Fushë Kosova**, me datë. 28.02.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Institucioneve të Komunës së Lipjanit” Autoriteti Kontraktues më datë 01.03.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Duke u bazuar në Legjislacionin e Prokurimit Publik, përkatësisht në Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik nr. A01 i cili ka hyrë në fuqi me datë; 01.02.2021 në nenin 56 pika 56.15 i cili përcakton ” Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë se secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët.


Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime të raportimit në KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (vetëm për riparime dhe mirëmbajtje).

AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Zyrtari përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtör i Prokurimit